



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE DHE ADMINISTRATIMIT TË UJËRAVE
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

PROJEKT-VENDIM

Nr 02 datë 29 / 12 / 2023

“ Për rinovim të kontratës ekzistuese të lidhur ndërmjet subjektit “KISI BIO ENERGJI” sh.p.k dhe ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Dibër dhe ish Komunës Selishtë ”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në zbatim të VKM - s Nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” Shtojca 6, bazuar në kërkesën e shoqërisë “KISI BIO ENERGJI” sh.p.k, me Nr.100 Prot. Tiranë më 29.07.2022, protokolluar pranë Bashkisë sonë me Nr. 3782 Prot. datë më 01.08.2022 për rinovimin e kontratës ekzistuese të qerasë të lidhur me ish Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Dibër me Nr.429/2 Prot. Peshkopi më 21.11.2011 dhe të ish Komunës Selishtë “Për dhënien në përdorim të Fondit Pyjor/Kullozor” për mbledhjen e Këshillit Bashkiak datë ____/____/ 2023 sektori i menaxhim - administrimit, Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave Bashkia Dibër:

PROPOZON:

1. Të rinovojë kontratën ekzistuese të qerasë me ish Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Dibër me Nr.429/2 Prot. Peshkopi më 21.11.2011 dhe të ish Komunës Selishtë “ Për dhënien në përdorim të Fondit Pyjor/Kullozor”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në Bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Dibër.

Për Bashkinë Dibër

Drejtoria Juridike

DREJTORI

Ismet SARACI

Përgjegjës i Sektorit të menaxhim administrimit

Ing.Vullnet Tafa

DREJTORI

Agron CARA

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU





REPUBLIKA E KOSOVËS

BASHKIA DIBËR

**DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE DHE ADMINISTRATIMIT TË UJËRAVE
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Nr. _____ Prot.

Peshkopi, më ____ / ____ / 2023

RELACION

Mbi projekt vendimin e paraqitur për rinovim të kontratës ekzistuese të lidhur ndërmjet subjektit "KISI BIO ENERGJI" sh.p.k dhe ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Dibër dhe ish Komunës Selishtë.

Shoqëria "KISI BIO ENERGJI" shpk me shkresën Nr.100 Prot. datë 29.07.2022, protokolluar pranë Bashkisë sonë me Nr.3782 Prot. datë më 01.08.2022, ka bërë kërkesë pranë Bashkisë Dibër për rinovimin e kontratës ekzistuese të qerasë të lidhur me ish Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Dibër me Nr.429/2 Prot. Peshkopi më 21.11.2011 dhe të ish Komunës Selishtë. Njësia Administrative Selishtë "Për dhënien në përdorim të Fondit Pyjor/Kullosor", që në bazë të vendimit Nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" Shtojca 6. është pronë publike e Bashkisë Dibër.

Kompania koncesionare "KISI BIO ENERGJI" shpk me shkresën me Nr. 130 Prot. Tiranë më 07.04.2023 i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me lëndë: "Kërkesë për asistimin e shoqërisë "KISI BIO ENERGJI" shpk pranë Bashkisë Dibër për rinovim kontratë qeraje për fondin pyjor/ kullosor", ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën me Nr. 3434/1 Prot. Tiranë më 06.06.2023 dhe shkresën Nr. 163. Tiranë më 06.11.2023, protokolluar pranë Bashkisë sonë me Nr.4323 Prot. datë më 07.11.2023 drejtuar Bashkisë Dibër në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, të kësaj kontrate koncesioni ka sjellë për trajtim kërkesën e shoqërisë "KISI BIO ENERGJI" shpk në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër me qëllim plotësimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti "KISI BIO ENERGJI" shpk kundrejt pagesës së qirasë vjetore përkatëse për rinovimin e kontratës ekzistuese kërkojmë nga ana e Këshillit Bashkiak miratimin e projekt vendimit të paraqitur. Bashkëngjitur po ju dërgojmë shkresat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë drejtuar për kompetencë Bashkisë Dibër në cilësinë e Autoritetit Kontraktues të kësaj kontrate koncesioni për trajtim të kërkesës së shoqërisë "KISI BIO ENERGJI" shpk në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Konceptoi:

Përgjegjësi i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave.

Ing.Vullnet TAFA

DREJTORI

Agron CARA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E ENERGJISË
DHE EFIÇENCËN E ENERGJISË

Nr. 3434/1 Prot.

Tiranë, më 06/06/2023

Lënda: Dërgohet për kompetencë

BASHKISË DIBËR

Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi

Për dijeni:

SHOQËRISË "KISI BIO ENERGJI" SHPK

Rr. "Rreshit Çollaku", Pallatet "Shallvare", Shkalla 17, Ap. 249 Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË BËRIMEVE NATYRORE

Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

Shoqëria "Kisi Bio Energji" sh.p.k, në cilësinë e shoqërisë koncesionare të kontratës së koncesionit të formës "BOT" Nr. 993 Rep., Nr. 179 Kol., datë 05.05.2008 për ndërtimin e hidrocentralit "Kacni", e ndryshuar, me shkresën Nr. 130 Prot., datë 07.04.2023 "*Kërkesë për asistimin e shoqërisë Kisi Bio Energji sh.p.k pranë Bashkisë Dibër për miratimin e kërkesës datë 29.07.2022, Nr. 100 Prot. me lëndë kërkesë për rinovim kontrate qiraje për fondin pyjor/kullosor kombëtar, heqje sipërfaqje nga fondi pyjor/kullosor kombëtar dhe dhënie në përdorim shoqërisë koncesionare Kisi Bio Energji*", protokolluar në MIE me Nr. 3434 Prot., datë 07.04.2023, kërkon ndërhyrjen e MIE-s pranë Bashkisë Dibër për të bërë të mundur vazhdimin e mëtejshëm të procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor publik dhe dhënie në përdorim të sipërfaqeve që preken nga ndërtimi i hec-it "Kacni I".

Autoriteti Kontraktues, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me Nenin 4, pika 4.1 të kontratës së koncesionit të sipërcituar, ka marrë përsipër detyrimin "*Të asistojë koncesionarin pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme, për marrjen e licensave dhe lejeve të nevojshme për koncesion*".

Për sa më sipër, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, të kësaj kontrate koncesioni, ju përcjellim për trajtim kërkesën së shoqërisë "Kisi Bio Energji" sh.p.k në zbatim të legjislacionit në fuqi, mbi bazën e të cilit operohet nga ana juaj.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Viola Haxhiademi

11/11/2023
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur është adresuar Bashkisë Dibër nga 1051 B10 Energy dhe mban nga dërguesi nr 163 prot. datë 06.11.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 4323 datë 07.11.2023.

Praktika u drejtohet për administrim:

- Znj/Z *[Signature]*
- Znj/Z *Drejtori të Bujqësisë dhe Pyjeve*
- Znj/Z *Drejtori Juridike, të Prokurimit dhe Marrëveshjeve*
- Znj/Z

me porosinë:

Administratori praktikës sipas kësaj

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë

Sipas afatit

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 07.11.2023

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

[Signature]



4323
07/11/23

Nr. Prot 163

Tiranë, më 06/11/2023

Drejtuar: Bashkisë Dibër
Kryetarit Z. Rahim Spahiu
Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi

Këshillit Bashkiak të Bashkisë Dibër
Kryetarit Z. Irini Shehu

Për dijeni: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
Sekretarit të Përgjithshëm Znj. Viola Haxhiademi

Lënda: Në lidhje me miratimin e kërkesës së shoqërisë KISI-BIO-ENERGJI Shpk datë 29.07.2022, nr. Prot. 100 për rinovim kontratë qiraje për fondin pyjor/kullosor dhe heqje sipërfaqeje nga fondi pyjor/kullosor kombëtar

Të nderuar zotërinj,

pavarësisht komunikimeve të vazhdueshme dhe të përsëritura me Bashkinë Dibër, kjo e fundit vazhdon të mos trajtojë kërkesën e shoqërisë KISI-BIO-ENERGJI Shpk ("KBE") datë 29.07.2022, nr. Prot. 100 për rinovim kontratë qiraje për fondin pyjor/kullosor dhe heqje sipërfaqeje nga fondi pyjor/kullosor kombëtar dhe miratimin në Këshillin Bashkiak. Theksojmë se edhe pas kërkesës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë datë 06/06/2023, nr. 3434/1 Prot. Bashkia Dibër vazhdon të zvarrisë trajtimin e kërkesës së shoqërisë konçesionare KISI-BIO-ENERGJI Shpk, në shkelje të së drejtave dhe interesit të ligjshëm të kësaj të fundit.

Bashkia Dibër dhe Këshilli Bashkiak i Bashkisë Dibër shkelin në mënyrë flagrante ligjin, duke zvarritur e penguar miratimin e kërkesës së shoqërisë KBE. Është e pashpjegueshme se si organet e pushtetit vendor sfidojnë ligjin dhe pengojnë realizimin e kontratës së konçesionit të lidhur mes KBE dhe Autoritetit Kontraktor, në kushtet kur autoritetet kompetente të fushës kanë dhënë miratimet përkatëse për trajtimin e kërkesës së shoqërisë KBE.

Sjellim në vëmendjen tuaj dhe të autoriteteve përgjegjëse se në mënyrë të paligjshme Bashkia Dibër i ka faturuar shoqërisë KBE detyrimin e qirasë për fondin pyjor/kullosor për vitin 2023 në vlerën totale 605,430 lekë, pa u rinovuar kontrata e qirasë mes palëve. Më konkretisht, i bëjmë referim faturave për arkëtim nr. 18 dhe nr. 19 të datës 24/01/2023, të cilat janë paguar nga KBE.

Faturimi dhe arkëtimi i pagesave të qirasë nga Bashkia Dibër në kushtet kur kjo e fundit zvarrit dhe pengon lidhjen e kontratës së qirasë me shoqërinë KBE, sipas kërkesës së kësaj të fundit, përbën një veprim të paligjshëm, në kufijtë e shpërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal).

Përveç dëmtimit të interesit publik nga mosrealizimi i hidrocentralit të ri "Kacni 1, mosrinovimi i kontratës së qirasë për fondin pyjor/kullosor dhe heqja e një sipërfaqeje të caktuar nga fondi pyjor/kullosor dëmton rëndë investimet e huaja në zonë dhe interesat e investitorëve të huaj. Shoqëria KBE nuk toleron dhe nuk do të tolerojë që të drejtat dhe interesat e ligjshme të shkelen



KISI BIO ENERGJI SHPK

nga veprimet e paligjshme të organeve të pushtetit vendor, duke rezervuar të drejtën e kërimit të shpërblimit të dëmit në rrugë gjyqësore.

Kërkojmë që pa humbur kohë të procedoni me miratimin e kërkesës së shoqërisë KISI-BIO-ENERGJI Shpk datë 29.07.2022, nr. Prot. 100 për rinovim kontratë qiraje për fondin pyjor/kullosor dhe heqje sipërfaqeje nga fondi pyjor/kullosor kombëtar. Çdo vonesë e zvarritje në trajtimin e kërkesës së shoqërisë KBE do të bëjë përgjegjës personat dhe institucionet përkatëse për dëmet që i shkaktohen shoqërisë konçesionare KISI-BIO-ENERGJI Shpk.


I bashkëlidhen kësaj shkrese:

1. Faturë për arkëtim e lëshuar nga Bashkia Dibër nr. 18, datë 24/01/2023;
2. Urdhër xhirimi i shoqërisë KBE datë 27/09/2023;
3. Faturë për arkëtim e lëshuar nga Bashkia Dibër nr. 19, datë 24/01/2023;
4. Urdhër xhirimi i shoqërisë KBE datë 27/09/2023.

Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj,

Për shoqërinë KISI-BIO-ENERGJI Shpk


Administrator Z. Julian Çela





Seria: 0000110

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
ZYRA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. 18

Datë 21 / 01 / 201


Me anë të kësaj fature kërkojme që banka juaj, të pranojë nga klientë (persona fizik / juridik) të kryejnë arkëtime të të ardhurave, për llogari të Bashkisë Dibër, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit përfitues BASHKIA DIBËR Subjekti: _____
Kodi i Institucionit 2106001 NIPT: _____
Kodi i Degës së Thesarit ku vepron 0606 Përfaqësuesi (fizik/juridik) _____

ID e Detyrimit	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që arkëtohet (lekë)
	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	
1.	Tarifë për dhënie me qera trualli (pasurie)	7109200	
2.	Kamatvonesë (vonesë në likuidimin e detyrimeve)	7115500	
3.	GJOBA	7115799	
TOTALI I DETYRIMIT			

Përfaqësuesi i Institucionit

Personi, Fizik, Juridik



Adresa: BASHKIA DIBËR, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bulevardi " Elez Isufi ", Peshkopi, Albania, nr.tel: 00355 2182 2936

Njoftim Debitimi / Debit Advice



Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX

Dega / Branch 900

Data / Date 27/09/2023

Payment Reference

P230927AHCOOP14

Klienti Urdherues / Ordering Customer

KISI-BIO-ENERGJI SHPK K86907701E

Numri i llogarise / Account Number

0030387417

IBAN

AL38202112570000000030387417

Shuma e urdheruar

462,000.00

Monedha

ALL

Kursi i kembimit

1.00000000

Detajet e pageses / Details of Payment

2106001 7109

200 PMT TARIF

E.DHENIE TRUALLI ME QERA KISI BIO E

N.

Komisione / Commissions

Klienti Perfitues / Beneficiary Customer

DEGA E THESARIT PESHKOPI K46908703V

Numri i llogarise

8604030886

IBAN

AL88202580090000008604030886

Date Valuta / Value Date

27/09/2023

Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti ritreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.



0000120

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
ZYRA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. 11Datë / /201


Me anë të kësaj fature kërkojme që banka juaj, të pranojë nga klientë (persona fizik / juridik) të kryejnë arkëtime të të ardhurave, për llogari të Bashkisë Dibër, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit përfitues BASHKIA DIBËR Subjekti: _____
Kodi i Institucionit 2106001 NIPT: _____
Kodi i Degës së Thesarit ku vepron 0606 Përfaqësuesi (fizik/juridik) _____

ID e Detyrimit	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që arkëtohet (lekë)
	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	
1.	Tarifë për dhënie me qera trualli (pasurie)	7109200	
2.	Kamatvonesë (vonesë në likuidimin e detyrimeve)	7115500	
3.	GJOBA	7115799	
TOTALI I DETYRIMIT			

Përfaqësuesi i Institucionit

Personi, Fizik, Juridik



Adresa: BASHKIA DIBËR, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, "Bullxardi" Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr tel. 00355 2182 2936

Njoftim Debitimi / Debit Advice



Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX

Dega / Branch 900

Data / Date 27/09/2023

Payment Reference P230927AEDVOP14

Klienti Urdherues / Ordering Customer KISI-BIO-ENERGJI SHPK K86907701E

Numri i llogarise / Account Number 0030387417

IBAN AL38202112570000000030387417

Shuma e urdheruar 143,430.00

Monedha ALL

Kursi i kembimit 1.00000000

Detajet e pageses / Details of Payment 2106001 7109
200 PMT TARIF
E.DHENIE TRUALLI ME QERA KISI BIO E
N.

Komisione / Commissions

Klienti Perfitues / Beneficiary Customer DEGA E THESARIT PESHKOPI K46908703V


Numri i llogarise 8604030886

IBAN AL88702580090000008604030886

Date Valuta / Value Date 27/09/2023

Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT UJERAVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR DIBËR

Adresa : Rruga e Tominit , Peshkopi, Tel. & Fax. 0218 2 2532& 0218 2 2531

Nr. 32/2 prot.

Peshkopi me 07.06.2011

RAPORT TEKNIK

PER DHËNIE NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR

Ky raport teknik hartohet sipas kërkeses se "Kisi-Bio-Energji" Sh.p.k, per dhenien ne perdorim te fondit pyJOR dhe kullorosor per ndertimin e nje H/C vendin e quajtur Perroi i Peshkut ne fshatin Kacni te komunes Selishte.

Grupi i specialisteve hartues hartues te ketij raporti përbëhet nga përgjegjësi i seksionit të administrim – menaxhimit **Ing. Munir Hoxha**, inspektori i kadastrës, **Ing.Vullnet Tafa**, dhe Inspektori i zones pyjore Kacni , **Tomorr Palluçi**, studjoi kërkesën e Shoqerise "Kisi-Bio-Energji" Sh.p.k, parashtruar bashkëlidhur për dhënie në përdorim të një sipërfaqeje te fondit pyJOR prej **0.785 ha**, gjatë një periudhe mbi **10 vjeçare**, me qellim per vendosjen e tubacionit per shfrytezimin e Prurjeve ujore te zones se fshatit Kacni komuna Selishte , te rrethit Diber per prodhim energjie elektrike.

Mbështetur në të dhënat e kadastrës pyjore dhe matjet në vend, rezulton se sipërfaqja e kërkuar është : **0.785 ha**, bën pjesë në **ekonomine pyjore "Kacni"**, **ne pellgun e Perroit te Peshkut**, qe perfshihet ne juridiksionin e sektorit te pyjeve Selishte, Drejtoria e Sherbimit PyJOR Diber, si me poshte:

-**Ngastrat / nenngastrat** : 70/a; 71/b; 72/a; 73/a; 74/a; 75/a,b,c; 76/c. (shih planimetrinë në shkallë , 1:10 000 bashkëlidhur), qe pershkrohen per ndertimin e **kanalit dhe vendosjen e tubacionit** per ndertimin e **HEC-it**, dhe bejne pjese ne ekonomine pyjore "Kacni" si vijon :


1.- (Ngastrat nr. **70/a;71/b;72/a;73/a;74/a**; jane prone shteterore ,

2.- dhe ngastrat, **75/a,b,c; 76/c** , i kane kaluar ne pronesi komunes Selishte).

Përdorimi i territorit dhe përkrahimi i përgjithshëm i tij rezulton sa parashtrohet në **Shtojcën 1** të këtij raporti.

Treguesit kryesorë të vegjetacionit sipas ngastrave pasqyrohen në **Shtojcën 2** të këtij raporti.


Treguesit kryesorë të kullotës dhe gjahut jepen në **Shtojcën 3** bashkëlidhur këtij raporti.



- Ndërhyrjet e propozuara nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, , gjë që pasqyrohet dhe në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti kërkues që përbëhet nga:
 - a). Përdorimi i nje sipërfaqe prej **0.01 ha, për** ndërtimin e nje prite për vepren e marrjes se ujit,(rezervuar i vogel) për t'u futur uji ne tubacion.
 - b). dhe **0.775 ha** për ndërtimin e **kanalit dhe vendosjen e tubacionit për ndërtimin e HEC-it**, dhe bejne pjese ne ekonomine pyjore "**Kacni**", ne nje gjatesi ne fondin pyjor prej **3100 ml**, dhe nje gjeresi prej **2.5 m**. Ndersa vet H/C dhe vendosja e turbinave dhe aparturave do te behet ne toke bujqesore private.
 - Shoqeria "**Kisi Bio-Energji**" *Sh.p.k*, merr në përdorim dhe kryen aktivitetin pas miratimit të raportit teknik, lidhjes së kontratës me DSHP Diber dhe likuidimit të tarifës për hartimin e raportit teknik prej **30000 lek, vetem për vitin e pare**.

Ne baze te VKM nr. 391, date 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", **te ndryshuar me VKM nr. 1064, date 22.12.2010** "Për disa ndryshime ne VKM nr. 391, date 21.06.2006 ,Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", tarifa e dhënies në përdorim, **bazuar në afatin kohor prej 6- 10 vjet**, në shumën prej : **853 957 leke** e cila konsiston në:

 - a) Tarifa për shtrirje tubacionesh dhe linjash ne sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, gazi, tension elektrik etj.), **me kohezgjatje ,6-10 vjet, sipas pikes nr. 11, te VKM nr. 1064, date 22.12.2010** , llogaritet ne **Vlerën prej : 446 300 leke/vit**, (nga te cilat, **336500 lek për shtetin D.Sh.P. Diber dhe 109800 leke për komunen e Selishtes**)
 - b) Tarifa për ndërtimin/përdorimin e rruges qe do te shfrytëzohet për vendosjen e tubacionit dhe transportin e materialeve , **sipas pikes nr. 12, te VKM nr. 1064, date 22.12.2010** , llogaritet ne **Vlerën prej : 152 150 leke, kjo shume do te paguhet vetem për nje vit, sepse mbas mbarimit te punimeve , pra futjes se tubacioneve ne toke, nuk do te funksionojë rruga .**
Kjo shume sipas pronesisë llogaritet : **119400 leke për shtetin D.Sh.P. Diber dhe 32750 leke për komunen e Selishtes**)
 - c) Tarife rezervuari ne sipërfaqen e zene nga ndërtimi i prites për devijimin e ujit me vlere prej: **27 000 leke/vit, qe i detyrohet shetit (D.Sh.P. Diber)**
 - d) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës prej **198 507 leke, qe i detyrohet D.Sh.P. Diber**, dhe përbëhet nga (i) vlere e lëndës së punimit **71 067 leke**, (ii) vlere e druve të zjarrit **4 940 leke**, (iii) vlere e prodhimeve të dyta pyjore **1000 leke**, (iv) kullotja **500 leke**, (v) vlere e faunës **1000 leke**, (vi) vlere e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmiresime, etj) **0 leke**, dhe (vii) të tjera **120 000 lek**.
 - Shoqeria "**Kisi-Bio-Energji**" *Sh.p.k*, merr në përdorim dhe kryen aktivitetin pas miratimit të raportit teknik, lidhjes së kontratës dhe likuidimit ne total te shumes prej : **853 957 lek për vitin e pare dhe 473 300 lek/vit për vitet e tjera**.



PERPILUESIT E RAPORTIT TEKNIK

Insp. i Z.pyjore Kacni

Insp. i kadastrës

Pergj. i seksionit Ad-Menaxh.

Tomorr Palluçi

Ing.Vullnet Tafa

Ing. Munir Hoxha





Kryetari i komunes Selishte

Drejtori i D.Sh.P. Diber

Xhemal Delishi

Gafur Gazidede



Shtojca 1 – Përshkrimi i territorit

1. Përdorimi i territorit, qeverisja, funksioni


Ngastra / n/ngastra,	Sipërfaqe Gjith. ha	Sip.per te dh. Ne perd. ha	Përdorimi i territorit	Forma e qeverisjes	Funksioni kryesor	Funksioni i vecantë	Infrastruktura ekzistuese
70/a	6.0	0.0150	Pyll	Trungishte	Prodhues	Lende drusore	s'ka
71/b	29.5	0.2000	Shkemb. Pj.pyll	Shkemb	Shkemb	Shkemb	s'ka
72/a	15.5	0.1375	Pyll	Trungishte	Prodhues	Lende drusore	s'ka
73/a	24.75	0.1125	Pyll	Trungishte	Prodhues	Lende drusore	s'ka
74/a	20.0	0.1050	Pyll	Trungishte	Prodhues	Lende drusore	s'ka
75/a	8.0	0.0500	Pyll	Trungishte	Prodhues	Lende drusore	s'ka
75/b	9.0	0.0875	Shkembor	Shkembor	Shkembore	Shkembore	Afer rruges
75/c	2.0	0.0450	t.b.pyjore erod.	t.e eroduar	Toke e eroduar	Toke e eroduar	Afer rruges
76/c	3.75	0.0375	Shkembor	Shkembor	Shkembore	Shkembore	Afer rruges
Shuma		0.7900					

2. Përshkrimi i përgjithshëm i territorit

Ngastra/ n/ngastra	Konfiguracioni	Kundrejtimi	Lartësia mbi niv.e detit	Pjerrësia
70/a	shpat	L	1600	21 grade
71/b	lugine	V-L	1625	25 grade
72/a	shpat	V-L	1310	28 grade
73/a	shpat	V-L	1200	36 grade
74/a	shpat	V-L	1200	34 grade
75/a	shpat	V-L	1150	33 grade
75/b	shpat	J-L	1000	33grade
75/c	shpat	J	950	35 grade
76/c	shpat	J-L	925	35 grade

3. Toka

Ngastra/nenngasta.	Tipi i tokës	Thellësia	Shkëmbi amnor	Gurët në sipërfaqe
70/a	Murme pyjore	E ceket	Serpentinor	Te paket
71/b	Shkemb,+m. py	Sh.e ceket	Serpentinor	Te shumte
72/a	Murme pyjore	E ceket	Serpentinor	Te paket
73/a	Murme pyjore	E ceket	Serpentinor	Te paket
74/a	Murme pyjore	E ceket	Serpentinor	Te paket
75/a	Murme pyjore	E ceket	Serpentinor	Te paket
75/b	Shkemb,+m. py	Sh.e ceket	Serpentinor	Te shumte
75/c	Shkembore	Shkembore	Shkembore	Shkembore
76/c	Shkembore	Shkembore	Shkembore	Shkembore




Shënim : Kategoritë e përdorimit të territorit, të cilat pasqyrohen dhe në planet e mbarështrimit të pyjeve, do të jene si me poshtë vijon

Pyll	Sipërfaqe të zëna nga masivët dhe drurët pyjore, zonat e ripyllëzuara, sipërfaqet boshe brënda pyllit (çeltira), pyjet e arrës, gështenjës dhe të shkurreve me sipërfaqe më të madhe se 0.1 ha dhe shkallë mbulimi mbi 30%.
Sipërfaqe me bimësi pyjore	Sipërfaqe të zëna nga masivet dhe drurët pyjorë, zonat e ripyllëzuara, sipërfaqet boshe brënda pyllit, pyjet e arrës, gështenjës dhe të shkurreve me sipërfaqe më të madhe se 0.1 ha dhe shkallë mbulimi 5 – 30 %.
Kullotë / livadh	Sipërfaqe të zëna nga kullotat, përfshirë dhe ato me drurë dhe shkurre.
Djerrë	Sipërfaqe të zhveshura me mundësi përdorimi.
Jo prodhuese	Zona ranishte, shkëmbore, gurore, mbeturina minerali, etj.
Sipërfaqe ujore	Liqenet, rezervuarët, etj.
Kënetë / moçal	Kënetat, moçalet, zonat e lagura.
Bujqësore	Tokat bujqësore, fidanishtet, ullishtet, dru frutorët, fermat e kafshëve, komplekset agro-industriale, serat, etj.
Urbane	Zonat e banuara dhe industriale, infrastruktura e transportit, parqet publike.

Përshkrimi i përgjithshëm i territorit do të bëhet konform kritereve të mëposhtëme:

Konfiguracioni i relievit	(i) rrafsh, (ii) kulm, (iii) shpat, (iv) fund shpati, (v) gropë.
Kundrejtimi	Veri, jug, lindje, perëndim, veri-perëndim, veri-lindje, jug-lindje, jug-perëndim, zenith.
Lartësia mbi nivelin e detit	Jepet në m.
Pjerrësia	(i) e vogël 0 – 10%, (ii) e mesme 11 – 40%, (iii) e madhe 41 – 70%, (iv) shumë e madhe > 70%.
Tipi i tokes	(i) livadhore – malore, (ii) e murrme pyjore, (iii) të kafejta, (iv) të hinjta kafe, (v) aluvionale, (vi) mocalishte, (vii) të kripura.
Thellësia	(i) shumë e cekët (< 15 cm), (ii) e cekët (16 – 30 cm), (iii) mesatare (31 – 60 cm), (iv) e thellë (> 60 cm).
Shkëmbi amnor	(i) gëlqeror, (ii) ultrabazik, (iii) flyshe, (iv) argjila, (v) të tjera.
Gurët në sipërfaqe	- përqindja e gurëve në sipërfaqe; - shpërndarja: (i) të përqëndruar, (ii) të shpërndarë.

Përshkrimi i vegjetacionit do të bëhet në përputhje me kriteret e mëposhtëme:



Forma e qeverisjes	(i) trungishte, (ii) cungishte, (iii) trungishte e përbërë, (iv) cungishte e përbërë, dhe (v) shkurre.
Funksioni kryesor	(i) prodhues, (ii) mbrojtës, (iii) konservues, dhe (iv) rekreacion.
Funksionet e vecanta	(i) prodhime drusore, nga këto lëndë punimi, dru zjarri; (ii) prodhime të dyta: fruta (specifiko gështenjat dhe arrat), boce, hunj, thupra, rrënjë, fara, lëvore, kërpudha, bar, gjethe, grumbullim humusi, të tjera; (iii) prodhime specifike: gurë, gëlqere, minerale, qymyr druri; (iv) bimë mjeksore.
Funksionet e vecanta të pyjeve mbrojtës	(i) toka, (ii) uji, (iii) klima, (iv) infrastruktura.
Funksionet e vecanta të pyjeve konservues	(i) pejsazh, (ii) habitat i vecantë, (iii) flora, (iv) fauna, (v) monument natyre, (vi) monument historik, (vi) rezerve gjenetike A, B, (vii) të tjera.
Funksionet e vecanta të pyjeve për rekreacion	(i) parqe, (ii) zona turistike, (iii) të tjera
Funksione të tjera	specifiko jashtë atyre të lartpërmendura

Për sa i përket kullotave, treguesit do të pasqyrohen si më poshte vijon:

Periudha e përdorimit	verore, dimërore, gjithë vitin
Mënyra e përdorimit	familjare, kolektive
Shkalla e mbulimit ne %	drurë, shkurre, bimësi barishtore
Probleme	mbikullotje, kullotje e paligjësme, pronësia
Gjendja e kullotes	shumë e mirë (< 10% e sip. e papërdorëshme), e mirë (10 – 30% e sipërfaqes e papërdorëshme), mesatare (30 – 60% e sipërfaqes e papërdorëshme), e degraduar (>60% e sipërfaqes e papërdorëshme)
Kafshët që kullosin, kapaciteti	dele, dhi, të trasha
Intensiteti kullosor	i ulët (kullotja është nën kapacitetin kullosor), normal (kullotja është brënda kapacitetit kullosor), i lartë (kullotja është mbi kapacitetin kullosor).

Për infrastrukturën jepet tipi, lloji dhe gjendja sipas këtij klasifikimi:

Tipi i infrastrukturës	për transport, për rekreacion, ngrehina, mbrojtëse, për mbrojtje nga zjarri, kullota, gjahu, të tjera.
Lloji i infrastrukturës	- për ngrehina: (i) godina, (ii) stacione, (iii) baraka; - për transport: (i) rrugë për kamion, (ii) rrugë për traktorë, (iii) rrugë për vetura, (iii) shtigje këmbësorësh, (iv) shtigje kafshësh, (v) teleferikë, (vi) lugje, (vii) të tjera;



	<p>- për rekreacion: (i) vende pikniku, (ii) ndërtesa për qëllime didaktike, (iii) kulla vrojtimi, (iv) të tjera;</p> <p>(iv) mbrojtëse: (i) sistemime toke, (ii) mure mbajtëse, (iii) tarraca, (iii) prita, (iv) diga kundër orteqeve, (v) të tjera;</p> <p>- për mbrojtjen nga zjarri: (i) kulla vrojtimi, (ii) basene ujore, (iii) depozita ujore, (iv) koridore kundër zjarrit;</p> <p>- për kullota: (i) stane, (ii) lera, (iii) korita, (iv) cezma, (v) vathë, (vi) të tjera;</p> <p>- për gjahun: (i) ushqimore, (ii) kulla vrojtimi, (iii) rrethime, (iv) të tjera;</p> <p>- të tjera: (i) fidanishte, (ii) të tjera.</p>
Gjendja e infrastruktures	(i) e papërdorëshme, (ii) e përdorëshme pas përmirësimeve, (iii) e përdorëshme



Shtojca 2 – Përshkrimi i vegjetacionit


1. Treguesit kryesorë të grumbullit pyjor

Ngastra, n/ngastra	Tipi i grumbullit	Katet	Gjendja e grumbullit	Filizëria	Nënpylli
70/a	Pyll i perz. Ah, Arnen	Njekate	mesatare	E mire	mungon
71/b	Shkembore	-	-	-	-
72/a	P.Ahu i thje.+pjesm.arn.	Njekate	mesatare	Nuk ka	mungon
73/a	Pyll i perz.Pish,Ah,Lis..	Njekate	mesatare	Ne 20% sip	mungon
74/a	Pyll i perz.Pish,Ah,Lis..	Njekate	mesatare	Ne 10% sip	mungon
75/a	Pyll i perz. Pise z.,lis	Njekate	mesatare	Nuk ka	mungon
75/b	Shkembore	Shkembore	Shkembore	Shkembore	
75/c	Shkembore	Shkembore	Shkembore	Shkembore	
76/c	Shkembore	Shkembore	Shkembore	Shkembore	

2. Karakteristikat dendrometrike

Ngastra, n/ngastra	Kati	Lloji, përbërja	Kd	Mosha	D mes	H mes	Kl. prodh	V. total	L. punimi	D. zjarri
70/a	Nje kat	5ah+5arn	0.9	85,80	18,26	18,22	V	902	752	150
71/b	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
72/a	Nje kat	10ah	0.8	105	26	17	V	2265	1845	420
73/a	Nje kat	4pi,5ah,1li	0.3	65,105	15,26	14,22	V	1327	1057	270



74/a	Nje kat	7pi,2ah,1li	0.5	55,125	14,28	14,24	V	1088	868	220
75/a	Nje kat	9 pi, 1 lis	0.8	70,15	18,5	10,3	V	320	250	70
75/b	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
75/c	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
76/c	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

3. Bimësia barishtore


Ngastra, n ngastra	Siperfaqja ne %	Leguminoze %	Graminore %	Te tjera ne %
70/a	6.0	-	80	20
71/b	29.5	-	bimesi e rralle	bimesi e rralle
72/a	15.5	-	85	15
73/a	24.75	-	85	15
74/a	20.0	-	70	30
75/a	8.0	-	70	30
75/b	9.0	-	bimesi e rralle	bimesi e rralle
75/c	2.0	-	bimesi e rralle	bimesi e rralle
76/c	3.75	-	bimesi e rralle	bimesi e rralle

Shtojca 3 – Kullota, gjahu

1. Kullota


Ngastra, n ngastra	Gjendja e kullotës	Periudha e përdorimit	Mënyra e përdorimit	Kap. dhen	Kap.te dhirta	Kap.te trasha	Intensiteti kullosor
70/a	-	-	-	-	-	-	-
71/b	e dobet	verore	kolektive	30	-	-	i dobet
72/a	mesatare	verore	kolektive	15	-	-	i dobet
73/a	mesatare	verore	kolektive	25	-	-	i dobet
74/a	mesatare	verore	kolektive	20	-	-	i dobet
75/a	mesatare	verore	kolektive	10	-	-	i dobet
75/b	e dobet	verore	kolektive	10	-	-	i dobet
75/c	e dobet	verore	kolektive	5	-	-	i dobet
76/c	e dobet	verore	kolektive	30	-	-	i dobet


2.Gjahu



Ngastra, n_ngastra	Speciet kryesore	Intensiteti i gjuetise
70/a	Lepur,ujk.ari,dhelper th.mali,etj	i paket
71/b	Thelleze mali etj.	i paket
72/a	Lepur,ujk.ari,dhelper th.mali,etj	i paket
73/a	Lepur,ujk.ari,dhelper th.mali,etj	i paket
74/a	Lepur,dhelper th.mali,etj	i paket
75/a	Lepur,dhelper th.mali,etj	i paket
75/b	Thelleze mali etj.	i paket
75/c	Thelleze mali etj.	i paket
76/c	Thelleze mali etj.	i paket

[Handwritten signatures]





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU DIBER
KOMUNA SELIShte

Nr. _____ Prot.

Selishte, më 01.12.2011

KONTRATE QIRAJE

PER
DHENIEN NE PERDORIM TE FONDIT PYJOR/KULLOSOR KOMUNAL

Në Selishte, sot në datë 01.12.2011, ne zbatim të nenit 19 e vijues të Ligjit nr.9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, nenit 17 e vijues të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, si dhe te nenit 801 e vijues te ligjit Nr. 7850 date 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë”, lidhet kjo kontrate qiraje midis:

I. PALET :


1. Komuna Selishte , e përfaqësuar nga Kryetari Xhemal Delishi e cila ne këtë kontrate është “Qiradhënësi” dhe kështu do te thirret me poshtë.

2. Subjekti “KISI-BIO-ENERGJI” SHPK (këtu e më poshtë referuar si “Qiramarrësi”), regjistruar si person fizik/juridik me nr. NIPT sipas ekstraktit të Q.K.R. përfaqësuar ligjërisht nga Administratorja Yllka Lala, e cila ka leshuar me autorizimin/prokurë Nr.2621 rep e nr. 540 kol. Datë 13.10.2010, e rikonfirmuar me nr. 2458 rep. Date 04.10.2011, per Perfaqesuesin e Pergjithshem Rahim Lala (i identifikuar nga ana jone me karte identiteti nr. 026184883) i cili në këtë kontrate është “Qiramarrësi” dhe kështu do te thirret me poshtë.

II. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Duke qenë se ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate, Palët bien dakord si vijon:

a. **Kushtet Paraprake dhe Shtojcat**



Kushtet Paraprake dhe Shtojcat përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.

b. Përcaktime

- **Sipërfaqe përdorimi:** Vendi në të cilën do të ushtrohet veprimtaria për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të saj, të miratuar.
- **Rruge Kalimi/E Drejta e Kalimit:** Rruga nga rruga kryesore për të hyrë në sipërfaqen e marrë në përdorim. Aktualisht është pjesë e fondit pyjor/kullosor kombëtar, e administruar nga Qiradhënësi, dhe do ti shërbejë Qiramarrësit.
- **Qiradhënës:** autoriteti shtetëror që zotëron të drejtën e përdorimit e përgjigjet për menaxhimin e administrimin e fondit pyjor/kullosor;
- **Qiramarrës:** individë, grup individësh (përfaqësuar nga një person i zgjedhur, të lidhur me marrëveshje noteriale,) shoqata e subjekte fizike e juridike.

Neni 1

Objekti i kontratës

1.1 Qiradhënësi i jep me qira Qiramarrësit "**KISI-BIO-ENERGJI**" SHPK për përdorim sipërfaqen prej **2200 (dy mijë e dyqinde) metër katror (m²)**, e cila është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, **ekonomia pyjore/kullosore "Kacni" ngastra nr.75/a;75/b;75/c;dhe 76/c**, me këto kufizime dhe koordinata:


Kufizimet koordinatat

Veri _____	X _____	Y _____
Jug _____	X _____	Y _____
Lindje _____	X _____	Y _____

Perëndim _____, në administrim nga DSHP (Nj.Q.V) _____ për ushtrimin e veprimtarisë _____.

1.2 Qiradhënësi i jep gjithashtu Qeramarrësit "**KISI-BIO-ENERGJI**" SHPK për përdorim edhe sipërfaqen prej **2200 (dy mijë e dyqinde) për rrugë kalimi/e drejte kalimi**, për të bërë të mundshëm kalimin nga rruga kryesore për në sipërfaqen e marrë në përdorim për gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate, nëpërmjet pasurisë së paluajtshme në administrim të Qiradhënësit, që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Vendndodhja e sipërfaqes së dhënë në përdorim dhe rruga hyrëse tregohen në hartën bashkëngjitur kësaj kontrate si *Shtojca 1*.



M.M.P.A.U.

LBA

Neni 2
Qëllimi

Kontrata për dhënie në përdorim të sipërfaqes së përcaktuar në nenin 1 të saj, për ushtrimin e veprimtarisë, “**Per te drejten e kalimit dhe ndertimin e tubacioneve të presionit ,sifoneve dhe baseneve të presionit**”, është e vlefshme vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga Ministri për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë si dhe në Lejen e Mjedisit.

Neni 3

Afati i kontratës

- 3.1 Kontrata e Qerasë lidhet për një afat deri 10 (dhjetë) vjeçar, duke filluar nga data 03.10.2011 deri në datën 03.10.2021, me te drejte rinovimi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.
- 3.2 Tre (3) muaj përpara përfundimit të afatit të mësipërm, secila Palë duhet të njoftojë Palën tjetër për të negociuar shtyrjen e afatit të kontratës për të njëjtën periudhë ose për përfundimin e saj.
- 3.3 Në mungesë të këtij njoftimi ose të ndonjë komunikimi midis Palëve, Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 4

Vlera e qerases vjetore



Vlera e qirasë vjetore për vitin 2011, (vetem për muajin, dhjetor 2011) është: **14 343 leke**, e llogaritur sipas VKM Nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, të ndryshuar me V.K.M. 1064 datë 22.12.2010.

Per vitet e tjera vlera e qirase vjetore eshte 143 430 leke ne vit.

Neni 5

Pagesa dhe regjimi i saj

- 5.1 Pagesa e qerasë do të bëhet çdo vit sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 5.2 Pagesa e pare do të bëhet brenda dhjetë (10) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës nga Palët.
- 5.3 Çdo pagese tjetër e përvitshme do të kryhet brenda 10 ditëshit të parë të muajit janar të viteve pasardhëse. Vlera e qerases është e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të aktit nënligjor VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, të ndryshuar me V.K.M. 1064 datë 22.12.2010.
- 5.4 Qiraja do paguhet në llogarinë bankare me nr. 8603030536, të mbajtur prej tij pranë Bankes Reiffarisen, ose në çdo llogari tjetër bankare të cilën Qiradhënësi do të njoftojë me shkrim Subjektin.



- 5.5 Në rast se Qeramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa me sipër, **Qiradhënësi përfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10 % e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse.** Për efekt të llogaritjes së kamatëvonesave do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 5.3 të kësaj kontrate.

Neni 6


Te drejtat dhe detyrimet e qiradhenesit

- 6.1 Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon qiramarrësit mundesine qe ta gëzoje dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.
- 6.2 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera qe, nuk kane të bëjnë sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës.
- 6.3 Qiradhënësi ka të drejte të kërkoje zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të përcaktuara në kushtet e Lejes Mjedisore si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.

Neni 7

Te drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

- 7.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Qiramarrësi ka të drejte qe për të punësuarit e saj, agjentët, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që subjekti konsideron të përshtatshëm, (të punësuar, të deklaruar dhe regjistruar në organet tatimore), të ketë të drejtë të hyjë lirisht në sipërfaqen e dhënë në përdorim objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në zbatim të kushteve dhe qëllimit të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 6 të kësaj kontrate; të transportojë persona, mallra, pajisje dhe materiale të tjera brenda sipërfaqes të marrë me qira, lejohet të bëjë ndërtime të përkohshme si dhe punime të tjera të çdo natyre në përputhje me kërkesat e projektit teknik të miratuar dhe kushteve të Lejes Mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të saj.
- 7.2 Qiramarrësi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimim e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga Qiradhënësi për ushtrimin e veprimtarisë.
- 7.3 Qiramarrësi nuk ka të drejte të japë me nën qira dhe të lidhe nën kontraktime me subjekte të tjerë apo, t'ia kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.
- 7.4 Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do t'i konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marre në përdorim dhe në Rrugën e Kalimit.
- 7.5 Qiramarrësi, do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.



- 7.6 Qiramarrësi ka për detyrim, të mbroje dhe mireadministroje sipërfaqen pyjore/kullosore ne përputhje me dispozitat e Ligjit 9385, date 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe të Ligjit Nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullosor”, të ndryshuar.
- 7.7 Qiramarrësika për detyrim, të lejoje dhe të shoqëroje punonjësit e Shërbimit Pyjor të ushtrojnë kontrollë për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuar në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor të dhënë në përdorim.
- 7.8 Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozite ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.
- 7.9 Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen kërkesat e neneve 37 dhe 38 të ligjit 9385, date 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

Neni 8

Detyrime të perbashketa të paleve

- 8.1 Në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj, “Qiramarrësi” do të rehabilitojë sipërfaqen për çdo dëmtim që mund të jete shkaktuar gjatë veprimtarisë, dhe do ta dorëzojë sipërfaqen e marre, siç ishte në gjendjen fillestare, përveç konsumimit fizik normal.
- 8.2 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Palëve do të bëhen me shkrim në adresat:

Për Qiradhënësin: **Kryetari i Komunes Selishte**

Xhemal DELISHI

Për Qiramarrësin: **Personi fizik/juridik “KISI-BIO-ENERGJI” SHPK Yilka LALA**

Neni 9

Forca madhore

Në rast se ndonjë nga Palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forca Madhore. Pëzullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forcës Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

Neni 10

Zgjidhja e kontrates

- 10.1 Kontrata zgjidhet me marrëveshje midis palëve si dhe me mbarimin e afatit të zgjatjes së kontratës, **date 03.10.2020.**
- 10.2 Kontratë bëhet menjëherë e pavlefshme, nëse nuk është nënshkruar pasi të jetë marrë miratimi nga Ministri, sipas kërkesave të nenit 19 të Ligjit nr.9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, nenit 17 të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”,



të ndryshuar, si dhe kur kontrata është e pashoqëruar me hartën përkatëse të gjeoreferuar në koordinatat përkatëse, si dhe të firmosur dhe vulosur D.Sh.PyJOR.

- 10.3 Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj në mënyrë të njëanshme, vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të mos kryerjes së pagesës së qirasë në afatin e caktuar, të mosrespektimit të kushteve të lejes mjedisore, për sipërfaqen e dhënë në përdorim nga Qiradhënësi.
- 10.4 Kontrata zgjidhet menjëherë kur sipërfaqja e dhënë në përdorim kërkohet për interesa publike të miratuara nga K.RR.T. apo K.RR.T.R.Sh.
- 10.5 Kontrata zgjidhet menjëherë kur sipërfaqja e dhënë në përdorim përshkohet nga zjarri.
- 10.6 Kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme kur Qiramarrësi, për sipërfaqen që kryen veprimtarinë nuk e ka rehabilituar në përputhje me planin e rehabilitimit të miratuar nga organet përkatëse të ngarkuara me ligj.
- 10.7 Njoftimi për zgjidhjen e njëanshme të kontratës bëhet me shkrim 15 dite përpara zgjidhjes së saj.

Neni 11

Dispozita të fundit

Për çështjet që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme në rast se do lindin mosmarrëveshje midis paleve, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e qirasë.

Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim të palëve; në të kundërt në **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Diber**.

Çdo korrigjimi i kontratës, para dhe pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme.

Kjo kontrate qiraje u formulua në tre kopje origjinale, nga të cilat një e merr Qiramarrësi, një Komuna Selishte dhe një kopje dërgohet zyrtarisht dhe qëndron në arkivin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

P A L Ë T:

QIRADHËNËSI

Për Komunen Selishte, Diber

Kryetari

Xhemal Delishi




QIRAMARRËSI

Për Personin Fizik/Juridik


Administratori

Yllka Lala
Perfaqesuesi i Përgjithshëm

Rahim Lala



M.M.P.A.U.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR DIBER

Adresa: Rruga e Fshatit Tomin, Tel. 021822532 & Fax: 021822532

Nr. 429/17 Prot.

Peshkopi, më 21.11.2011

KONTRATE QIRAJE

PER

DHENIEN NE PERDORIM TE FONDIT PYJOR/KULLOSOR KOMBETAR

Në Peshkopi, sot në datë 21.11.2011, ne zbatim të nenit 19 e vijues të Ligjit nr.9385, datë 4.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, nenit 17 e vijues të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullor", të ndryshuar, si dhe te nenit 801 e vijues te ligjit Nr. 7850 date 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë", lidhet kjo kontrate qiraje midis:

I. PALET :

1. Drejtoria e Shërbimit Pyjor Diber , e përfaqësuar nga Drejtori Gafur Gazidede e cila ne këtë kontrate është "Qiradhënësi" dhe kështu do te thirret me poshtë.

2. Subjekti "KISI-BIO-ENERGJI" SHPK (këtu e më poshtë referuar si "Qiramarrësi"), regjistruar si person fizik/juridik me nr. NIPT sipas ekstraktit të Q.K.R. përfaqësuar ligjërisht nga Administratorja Yllka Lala, e cila ka leshuar me autorizimin/prokurë Nr.2621 rep e nr. 540 kol. Datë 13.10.2010, e rikonfirmuar me nr. 2458 rep. Date 04.10.2011, per Perfaqesuesin e Pergjithshem Rahim Lala (i identifikuar nga ana jone me karte identiteti nr. 026184883) i cili në këtë kontrate është "Qiramarrësi" dhe kështu do te thirret me poshtë.

II. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Duke qenë se ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate, Palët bien dakord si vijon:

a. Kushtet Paraprake dhe Shtojcat



Kushtet Paraprake dhe Shtojcat përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.

b. Përcaktime

- **Sipërfaqe përdorimi:** Vendi në të cilën do të ushtrohet veprimtaria për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të saj, të miratuar.
- **Rruge Kalimi/E Drejta e Kalimit:** Rruga nga rruga kryesore për të hyrë në sipërfaqen e marrë në përdorim. Aktualisht është pjesë e fondit pyjor/kullosor kombëtar, e administruar nga Qiradhënësi, dhe do ti shërbejë Qiramarrësit.
- **Qiradhënësi:** autoriteti shtetëror që zotëron të drejtën e përdorimit e përgjigjet për menaxhimin e administrimin e fondit pyjor/kullosor;
- **Qiramarrës:** individë, grup individësh (përfaqësuar nga një person i zgjedhur, të lidhur me marrëveshje noteriale,) shoqata e subjekte fizike e juridike.

Neni 1
Objekti i kontratës

1.1 Qiradhënësi i jep me qira Qiramarrësit "**KISI-BIO-ENERGJI**" SHPK për përdorim sipërfaqen prej **5650 (pesemijegjashteqindepesedhjetë) metër katror (m²)**, e cila është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, ekonomia pyjore/kullosore "**Kacni**" ngastrat nr.70/a;71/a;72/a;73/a; dhe 74/a, me këto kufizime dhe koordinata:

Kufizimet koordinatat

X _____	Y _____
Veri _____	X _____ Y _____
Jug _____	X _____ Y _____
Lindje _____	X _____ Y _____

Perëndim _____, në administrim nga DSHP (Nj.Q.V) _____ për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kontratës e raportit teknik të miratuar, në Ekonomine Pyjore "**Kacni**" (Ngastrat / nenngastrat : 70/a; 71/b; 72/a; 73/a; 74/a; 75/a,b,c; 76/c.)

1.2 Qiradhënësi i jep gjithashtu Qiramarrësit "**KISI-BIO-ENERGJI**" SHPK për përdorim edhe sipërfaqen prej **5550 m² për rrugë kalimi/e drejte kalimi**, për të bërë të mundshëm kalimin nga rruga kryesore për në sipërfaqen e marrë në përdorim për gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate. nëpërmjet pasurisë së paluajtshme në administrim të Qiradhënësit, që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Vendndodhja e sipërfaqes së dhënë në përdorim dhe rruga hyrëse tregohen në hartën bashkëngjitur kësaj kontrate si *Shtojca 1*.



Neni 2 Qëllimi

Kontrata për dhënie në përdorim të sipërfaqes së përcaktuar në nenin 1 të saj, për ushtrimin e veprimtarisë, “**Per te drejten e kalimit dhe ndertimin e tubacioneve të presionit ,sifoneve dhe baseneve të presionit**”, është e vlefshme vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga Ministri për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë si dhe në Lejen e Mjedisit.

Neni 3 Afati i kontratës




- 3.1 Kontrata e Qerasë lidhet për një afat deri 10 (dhjetë) vjeçar, duke filluar nga data 21.11.2011 deri në datën 21.11.2021, me te drejte rinovimi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.
- 3.2 Tre (3) muaj përpara përfundimit të afatit të mësipërm, secila Palë duhet të njoftojë Palën tjetër për të negociuar shtyrjen e afatit të kontratës për të njëjtën periudhë ose për përfundimin e saj.
- 3.3 Në mungesë të këtij njoftimi ose të ndonjë komunikimi midis Palëve, Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 4 Vlera e qerases vjetore

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2011, (për 3 muajt e fundit) është: **193 137 leke**, e llogaritur sipas VKM Nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, të ndryshuar me V.K.M. 1064 datë 22.12.2010, si dhe Vlera e llogaritur e demtimeve që i shkaktohen flores e faunes është: **462 600 leke**, vlerë e cila do të paguhet për çdo vit .

Neni 5 Pagesa dhe regjimi i saj

- 5.1 Pagesa e qerasë do të bëhet çdo vit sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 5.2 Pagesa e pare do të bëhet brenda dhjetë (10) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës nga Palët.
- 5.3 Çdo pagese tjetër e përvitshme do të kryhet brenda 10 ditëshit të parë të muajit janar të viteve pasardhëse. Vlera e qerases është e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të aktit nënligjor VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, të ndryshuar me V.K.M. 1064 datë 22.12.2010.



- 5.4 Qiraja do paguhet në llogarinë bankare me nr. **0100000116** , të mbajtur prej tij pranë ne **Raiffaisen Bank**, ose në çdo llogari tjetër bankare të cilën Qiradhënësi do të njoftojë me shkrim Subjektin.
- 5.5 Në rast se Qeramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa me sipër, Qiradhënësi përfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10 % e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatëvonesave do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 5.3 të kësaj kontrate.

Neni 6



Te drejtat dhe detyrimet e qiradhenesit

- 6.1 Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon qiramarrësit mundesine qe ta gëzoje dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.
- 6.2 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera qe, nuk kane të bëjnë sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës.
- 6.3 Qiradhënësi ka të drejte të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të përcaktuara në kushtet e Lejes Mjedisore si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.

Neni 7

Te drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

- 7.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Qiramarrësi ka të drejte qe për të punësuarit e saj, agjentët, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që subjekti konsideron të përshtatshëm, (të punësuar, të deklaruar dhe rregjistruar në organet tatimore), të ketë të drejtë të hyjë lirisht në sipërfaqen e dhënë në përdorim objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në zbatim të kushteve dhe qëllimit të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 6 të kësaj kontrate; të transportojë persona, mallra, pajisje dhe materiale të tjera brenda sipërfaqes të marrë me qira, lejohet të bëjë ndërtime të përkohshme si dhe punime të tjera të çdo natyre në përputhje me kërkesat e projektit teknik të miratuar dhe kushteve të Lejes Mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të saj.
- 7.2 Qiramarrësi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimim e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga Qiradhënësi për ushtrimin e veprimtarisë.
- 7.3 Qiramarrësi nuk ka të drejte të japë me nën qira dhe të lidhe nën kontraktime me subjekte të tjerë apo, t'ia kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.



- 7.4 Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do t'i konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marre ne përdorim dhe në Rrugën e Kalimit.
- 7.5 Qiramarrësi, do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.
- 7.6 Qiramarrësi ka për detyrim, të mbroje dhe mireadministroje sipërfaqen pyjore/kullosore ne përputhje me dispozitat e Ligjit 9385, date 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe të Ligjit Nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar.
- 7.7 Qiramarrësika për detyrim, të lejoje dhe të shoqëroje punonjësit e Shërbimit Pyjor të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave te përcaktuar ne kontrate për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor te dhënë ne përdorim.
- 7.8 Qiramarrësi detyrohet te zbatoje çdo dispozite ligjore qe del e re ose ndryshim qe u behet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.
- 7.9 Për çdo shkelje te konstatuar ne zbatim te pikave te mësipërme te kontratës, zbatohen kërkesat e neneve 37 dhe 38 te ligjit 9385, date 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar.

Neni 8

Detyrime te perbashketa te paleve

- 8.1 Në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj, "Qiramarrësi" do të rehabilitojë sipërfaqen për çdo dëmtim qe mund te jete shkaktuar gjate veprimtarisë, dhe do ta dorëzoje sipërfaqen e marre, siç ishte ne gjendjen fillestare, përveç konsumimit fizik normal.
- 8.2 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Palëve do të bëhen me shkrim ne adresat:

Për Qiradhënësin: **Drejtori i D.Sh.P. DIBER**

GAFUR GAZIDEDE

Për Qiramarrësin: **Personi fizik/juridik "KISI-BIO-ENERGJI" SHPK YLLKA LALA**

Neni 9

Forca madhore

Në rast se ndonjë nga Palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forca Madhore. Pezullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forcës Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

Neni 10

Zgjidhja e kontrates

- 10.1 Kontrata zgjidhet me marrëveshje midis palëve si dhe me mbarimin e afatit te zgjatjes se kontratës, **date 21.11.2021.**



- 10.2 Kontratë bëhet menjëherë e pavlefshme, nëse nuk është nënshkruar pasi të jetë marrë miratimi nga Ministri, sipas kërkesave të nenit 19 të Ligjit nr.9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, nenit 17 të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, si dhe kur kontrata është e pashoqëruar me hartën përkatëse të gjeoreferuar në koordinatat përkatëse, si dhe të firmosur dhe vulosur D.Sh.Pyjor.
- 10.3 Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj në mënyrë të njëanshme, vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të mos kryerjes së pagesës së qirasë në afatin e caktuar, të mosrespektimit të kushteve të lejes mjedisore, për sipërfaqen e dhënë në përdorim nga Qiradhënësi.
- 10.4 Kontrata zgjidhet menjëherë kur sipërfaqja e dhënë në përdorim kërkohet për interesa publike të miratuara nga K.RR.T. apo K.RR.T.R.Sh.
- 10.5 Kontrata zgjidhet menjëherë kur sipërfaqja e dhënë në përdorim përshkohet nga zjarri.
- 10.6 Kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme kur Qiramarrësi, për sipërfaqen që kryen veprimtarinë nuk e ka rehabilituar në përputhje me planin e rehabilitimit të miratuar nga organet përkatëse të ngarkuara me ligj.
- 10.7 Njoftimi për zgjidhjen e njëanshme të kontratës bëhet me shkrim 15 dite përpara zgjidhjes së saj.

Neni 11

Dispozita të fundit

Për çështjet që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme në rast se do lindin mosmarrëveshje midis palëve, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e qirasë.

Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim të palëve; në të kundërt në **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Diber**.

Çdo korrigjimi i kontratës, para dhe pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme.


Kjo kontratë qiraje u formulua në tre kopje origjinale, nga të cilat një e merr Qiramarrësi, një Drejtoria e Shërbimit Pyjor Diber dhe një kopje dërgohet zyrtarisht dhe qëndron në arkivin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

PALËT:

QIRADHËNËSI

Për Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Diber
Drejtori

Gafur Gazidede



M.M.P.A.U.

QIRAMARRËSI

Për Personin Fizik/Juridik
Administratori

Yllka Lala

Perfaqesuesi i Përgjithshëm

Rahim Lala

